

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Jellena Krivokapiq, kryetare, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtare, në çështjen juridike të paditësit Administrata Apostolike me seli ne Prizren te cilen e perfaqeson avokatja Ilirjana Osmani Sereqi nga Prishtina, Ulpiana C1/H1 nr.1/2, kundër të paditurës Komuna e Prishtines, te cilen e perfaqeson avokati publik komunal Heset Mazreku dhe te nderhyresit ne anen e t; paditures, Ndermarrja Publike Banesore (NPB) ne Prishtine, per vertetimin e drejtes se shfrytezimit dhe kompensimit te siperfaqes se munguar, vlera e kontestit 850.000,- euro, duke vendosur përkitazi me revizionet e paditësit dhe te paditures të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, CA nr.4016/2015 datë 15.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 20.02.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si te pabazuar revizionet e paditësit Administrata Apostolike e Prizrenit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit CA. nr.4016/2015 datë 15.02.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore ne Prishtine, C nr.2194/14 date 21.07.2015, eshte aprovuar pjeserisht si e bazuar kerkesepadia e paditesit dhe eshte vertetuar se paditesi eshte bartesi i te drejtes se shfrytezimit afatgjate te ngastres, nr.7355-0 ZK Prishtine, me siperfaqe 7655 m2, ne baze te kontrates 01 nr.353-34 te dates 02.07.2007, te lidhur me Komunen e Prishtines. Ne paragrafin II te ketij aktgjykimi eshte vertetuar se paditesi eshte shfrytezuesi faktik i siperfaqes 7655m2, e cila shtrihet ne pjese tani te ngastrave nr.7355-3 dhe 7355-1, e cila siperfaqe ne teresine e saj kufizohet nga ana veriperendimore dhe perendimore me rrugen Perandori Justinjan, nga ana lindore me rrugen Bulevardi Deshmoret e Kombit, dhe nga ana jugore me rrugen Bill Clinton, me dimensione dhe koordinata si vijon:

- i) Pjesa e ngastres kadastrale, tani 7355-3, ZK Prishtine me siperfaqe 6532m2, qe evidentohet ne emer te paditesit, me keto koordinata dhe dimezione:
 - Prej pikes 1-2, kufiri drejt dhe gjatesia e frontit 1.49 m,
 - Prej pikes 2-3, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 2.19 m,
 - Prej pikes 3-4, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 2.08 m,
 - Prej pikes 4-5, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 3.77 m,

- Prej pikes 5-7, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 0.92 m,
- Prej pikes 7-9, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 19.75 m,
- Prej pikes 9-10, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 16.43 m,
- Prej pikes 10-11, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 26.13 m,
- Prej pikes 11-12, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 10.97 m,
- Prej pikes 12-13, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 15.07 m,
- Prej pikes 13-14, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 11.41 m,
- Prej pikes 14-15, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 5.81 m,
- Prej pikes 15-16, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 2.67 m,
- Prej pikes 16-17, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 8.27 m,
- Prej pikes 17-19, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 10.38 m,
- Prej pikes 19-20, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 4.05 m,
- Prej pikes 20-22, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 6.72 m,
- Prej pikes 22-24, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 2.45 m,
- Prej pikes 24-27, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 17.88 m,
- Prej pikes 27-28, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 7.55 m,
- Prej pikes 28-30, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 8.96 m,
- Prej pikes 30-31, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 6.06 m,
- Prej pikes 31-33, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 5.61 m,
- Prej pikes 33-35, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 5.60 m,
- Prej pikes 35-38, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 9.83 m,
- Prej pikes 38-39, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 0.80 m,
- Prej pikes 39-46, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 19.19 m,
- Prej pikes 46-48, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 9.81 m,
- Prej pikes 48-49, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 4.32 m,
- Prej pikes 49-50, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 9.69 m,
- Prej pikes 50-51, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 21.27 m,
- Prej pikes 51-52, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 14.61 m,
- Prej pikes 52-53, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 4.03 m,
- Prej pikes 53-54, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 24.29 m,
- Prej pikes 54-55, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 2.78 m,
- Prej pikes 55-56, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 16.57 m,
- Prej pikes 56-58, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 9.07 m,
- Prej pikes 58-59, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 9.80 m,
- Prej pikes 59-60, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 2.80 m,
- Prej pikes 60-61, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 1.87 m,
- Prej pikes 61-4, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 9.83 m,

ii) Pjeset e ngastres kadastrale, tani 7355-1, ZK Prishtine, qe evidentohet ne emer te SHM Gjumnazi "Xhevdet Doda", me keto koordinata dhe dimensionet:

- a) Pjesa lindore e ngastres (pjesa e lokaleve ne ndertim) me siperfaqe prej 907m²,
 - Prej pikes 50-56, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 10.69 m,
 - Prej pikes 65-66, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 17.69 m,
 - Prej pikes 66-67, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 13.20 m,

- Prej pikes 67-68, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 9.28 m,
 - Prej pikes 68-69, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 78.45 m,
 - Prej pikes 69-1, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 2.25 m,
 - Prej pikes 1-61, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 3.73 m,
 - Prej pikes 61-60, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 1.87 m,
 - Prej pikes 60-50, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 108.38 m,
- b) Pjesa lindore e ngastres (nga ana e lokaleve ne ndertim) me siperfaqe 165 m2, me keto koordinata dhe dimensione:
- Prej pikes 50-60, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 108.35 m,
 - Prej pikes 60-59, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 2.80 m,
 - Prej pikes 59-58, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 9.80 m,
 - Prej pikes 58-57, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 9.07 m,
 - Prej pikes 57-56, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 6.50 m,
 - Prej pikes 56-55, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 16.57 m,
 - Prej pikes 55-54, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 2.78 m,
 - Prej pikes 54-53, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 24.29 m,
 - Prej pikes 53-52, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 4.03 m,
 - Prej pikes 52-51, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 14.61 m,
 - Prej pikes 51-50, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 21.27 m,
- c) Pjesa verilindore e ngastres, nga ana e lokaleve dhe rruges “Perandore Justinjan”, me siperfaqe 27 m2, me keto koordinata dhe dimensione:
- Prej pikes 1-2, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 3.67 m,
 - Prej pikes 2-3, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 4.20 m,
 - Prej pikes 3-4, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 2.69 m,
 - Prej pikes 4-61, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 9.83 m,
 - Prej pikes 61-1, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 3.73 m,
- d) Pjesa verilindore e ngastres, ne Sheshin “Deshmoret e Kombit”, me siperfaqe 19m2 dhe 5 m2, me keto koordinata dhe dimensione:
- Prej pikes 7-5, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 0.92 m,
 - Prej pikes 5-6, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 0.09 m,
 - Prej pikes 6-8, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 8.97 m,
 - Prej pikes 8-11, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 54.11 m,
 - Prej pikes 11-10, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 26.13 m,
 - Prej pikes 10-9, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 16.43 m,
 - Prej pikes 9-7, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 19.75 m,
 - Prej pikes 15-18, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 18.46 m,
 - Prej pikes 18-19, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 2-94 m,
 - Prej pikes 19-17, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 10.38 m,
 - Prej pikes 17-16, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 8.27 m,
 - Prej pikes 16-15, kufiri i drejt dhe gjatesia e frontit 2.67 m,

Ne paragrafin e III-te eshte obliguar e paditura Komuna e Prishtines, kete te drejte t'ia pranoje paditesit dhe ta lejoje regjistrimin e paluajtshmerise me matjet gjeodezike te pershkruara sipas paragrafit te mesiperm, ne regjistrin kadastral, si shfrytezues afatgjate.

Ne paragrafin e IV-te eshte refuzuar si e pabazuar pjesa tjetere e kerkesepadise se paditesit mbi siperfaqen e gjykuar nga paragrafi I i dispozitivit, sa i perket ngastres nr.7355-0, mbi siperfaqe 7655m2 deri ne siperfaqen 1.30 ha, sikunder qe refuzohet kerkesa e paditesit me te cilen ka kerkuar qe e paditura Komuna e Prishtines, paditesit si kompensim per siperfaqen e munguar nga kontrata 01 nr.353-34, sipas pikes 1 te dispozitivit, t'ia dorezoi ne shfrytezim afatgjate nje siperfaqe te lire, prej 5345 m2, ne territorin e Komunes se Prishtines.

Ne piken V te dispozitivit, masa e sigurimit qe eshte caktuar nga Gjykata e Apelit sipas Aktvendimit, Ac 2290/14 dt.30.07.2014, ka mbetur ne fuqi deri sa te merret nje vendim tjetere.

Dhe ne pikën VI është vendos që secila palë ndërgjyqëse i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi të dyja palët kanë paraqitur ankesë, paditësi duke e kontestuar aktgjykimin ankimor në pjesën refuzuese, ndërsa e paditura duke e kontestuar në tërësi, të cilën Gjykata e Apelit e ka refuzuar si të pabazuar (aktgjykimi CA nr. 416/2015 dt. 15.02.2018), dhe më të cilin është vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C nr.2149/2014 dt. 21.07.2015.

Të pakënaqur me këtë aktgjykim, të dyja palët brenda afatit ligjor kanë paraqitur revizion. Paditësi, për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale në pjesën refuzuese, ndërsa e paditura për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që revizionet e tyre të aprovohen si të bazuar. Përgjigje në revizion ka parashtruar pala paditëse, me propozim që revizioni i të paditurës të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimin të kontestuar, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, ka gjetur se revizionet janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin e datës 19.02.2002 ka përcaktuar lokacionin për ndërtimin e objektit të Katedrales në ngastrën kadastrale 6198 ZK Prishtinë, në sipërfaqe prej 1,20 ha, e pastaj me vendimin tjetër të datës 27.02.2002 ka bërë ndryshimin e lokacionit dhe ka përcaktuar ngastrën kadastrale nr.7355 ZK Prishtinë, në sipërfaqe prej 1,30 ha. Në bazë të kësaj, paditësi dhe e paditura kanë bërë kontratë për shfrytëzimin afatgjatë të ngastrës 7355 me sipërfaqe 1.30 ha, 01 nr.353-34 dt.02.07.2007, ndërsa paditësi ka marrë për obligim të paguaj shumën për ndërtimin e shkollës së mesme - Gjimnazi Xhevdet Doda, në një lokacion tjetër, në vlerë prej 850.000,- euro, kurse shumën prej 400.000,- euro e ka marrë për obligim ta paguaj Ministria e Arsimit dhe e Teknologjisë në Prishtinë. Paditësi ka përmbushur në tërësi obligimin e vet të kontratës. E paditura, me vendimin e datës 29.03.2007 dhe me veprim

të njëanshëm paditësit ia cakton sipërfaqën prej 6811 m² të ngastrës 7355-0, pa caktuar matjet gjeodezike. Bëhet fjalë për sipërfaqën ku ka qenë e ndërtuar SHM 'Xhevdet Doda'. Për këtë ndryshim nuk kanë qenë të informuar pushteti qendror, UNMIK-u apo Qeveria e Kosovës. Në ngastrën e lartpërmendur gjenden dhe objektet tjera siç janë: lokalet afariste, rruga publike-Sheshi Bill Clinton, pjesa e rrugës Dëshmorët e Kombit, Ministria e Financave, objekti i Elektrokosovës-Distribucioni, përkundër ekzistimit të vendimit të Kuvendit të Komunës të datës 27.02.2007 për ndërtimin e Katedrales, e paditura, në vitin 2005 e harton planin Rregullativ, lagjja Pejton dhe Qendra 2, kështu që për shkak të mos përputhjes së gjendjes faktike në teren të ngastrës nr. 7355-0 ka ardhur deri te shkaktimi i kontestit.

Lidhur me si më sipër, Gjykata Supreme vlerëson se në bazë të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë zbatuar dispozitat e LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale. Andaj, të dy gjykatat, drejtë kanë vendosur lidhur me pjesën aprovuese dhe refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit kundër të paditurës.

Nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 të LPK, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as shkelje tjera të theksuara në revizion. Është i pabazuar pretendimi se në aktgjykimin nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare. Ngastra kadastrale nr. 7355-0 e cila ishte objekt i kontratës që është lidhur në mes të ndërgjyqësve, paditësit dhe të paditurës, ka pasur të meta juridike. Të metat juridike janë se si pjesë e kontratës nuk ka mundur të jetë, një pjesë e kësaj ngastre që është shfrytëzuar për të mirën publike (trotuar, rrugë, sheshet dhe objektet tjera), dhe pse kjo pjesë nuk është regjistruar në regjistrin e paluajtshmërive. Kjo sepse Komuna apo Pushteti Qendror, Ministria e Arsimit, nuk kanë pasur autorizim ligjor të japin pëlqim ose të nënshkruajnë kontratë për një pjesë të sipërfaqes së ngastrës lëndore. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se si e tillë kontrata 01 nr.353-34 dt.02.07.2007 nuk mund të ketë efekt të plotë juridik, është pjesërisht e vlefshme për pjesën e saj të ekzekutueshme e cila nuk përfshin sipërfaqet e lartpërmendura publike, respektivisht objektet e rëndësisë së veçantë. Gjykatat e instancës së ulët kanë vlerësuar se këto të meta juridike e kanë bërë të pamundur edhe përmbushjen e kontratës në tërësi, sepse në bazë të ekspertizës gjeodezike u vërtetua se e paditura paditësit ja ka dorëzuar në posedim dhe shfrytëzim sipërfaqen faktike 6732 m², e jo siç ja ka bërë dhe regjistruar në regjistrin e paluajtshmërisë të drejtën e shfrytëzimit, me sipërfaqen 6814 m². Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktin se paditësi e ka përmbushur obligimin që ka pasur me kontratën, ndërsa e paditura nuk e ka përmbushur në tërësi (pjesërisht) obligimin e vet në kontratë, për shkaqe objektive (ka qenë pjesërisht i mundshëm për tu përmbushur pjesa e ngastrës lëndore me pjesën e trekënshit, duke menjanuar hapësirat e lokaleve private.). Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, për pjesën që kontrata nuk prodhon efekt juridik, gjejnë në zbatim dispozitat e nenit 46.2 lidhur me nenin 47 të LMD-së, se objekti i detyrimit duhet të jetë i mundshëm, i lejueshëm i caktuar, respektivisht i caktueshëm. Sipas dispozitës e nenit 47, kur objekti i detyrimit është i pamundur, i palejuar, i pa përcaktuar ose i cili nuk mund të caktohet, kontrata është nule. Në rastin konkret, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, një pjesë e kontrates mund të prodhojë efekt juridik, sa i përket ngastrës 7355-0 me sipërfaqe prej 7655m², ndërsa pjesa që nuk mund të prodhojë efekt

juridik është mbi këtë sipërfaqe e deri në sipërfaqen prej 1.30 ha. Për, e paditura ka përmbushur pjesërisht obligimin e marrë me kontratë duke ja liruuar pjesërisht sipërfaqen e tokës në pjesën ku e ka shfrytëzuar SHM 'Xhevdet Doda' që tani sipas ndarjes fizike ka marrë numrin e ngastrës 7355-3 dhe këtë ngastër ja ka regjistruar të drejtën e shfrytëzimit paditësit. Pjesa tjetër e kontratës nuk është përmbushur e që sipas ndarjes fizike e ka marrë numrin e ngastrës 7355-1, me sipërfaqe prej 907 m².

Gjykata Supreme e pranon në tërësi arsyetimin dhe vlerësimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët se paditësi ka fituar të drejtën e shfrytëzimit afatgjatë në bazë të kontratës 01 nr.353-34 dt.02.07.2007, që është lidhur në mes paditësit dhe të paditues-Komunës së Prishtinës, duke paguar shumën prej 850.000,-euro, në ngastrën kadastrale nr.7355-0 ZK Prishtinë, në sipërfaqe prej 7655m². Në këtë pjesë kontrata është realizuar, meqenëse nuk ka pasur pengesa juridike në përmbushjen e saj, ndërsa e paditura ia ka dorëzuar në posedim dhe shfrytëzim patundshmërinë përkatëse, respektivisht parcelën të cilën e ka shfrytëzuar shkolla që tani sipas ndarjes fizike ka marrë numrin 7355-3 dhe është regjistruar me nr.UL.71914059-12806, njësia kadastrale P-719114059-07355-3.E paditura nuk e ka përmbushur në tërësi obligimin e vetë në kontratë, për një pjesë të saj i cili ishte i mundshëm dhe i lejuar për tu përmbush, fjala është për pjesën e ngastrës 7355-0 e cila pas ndarjes fizike ka marrë numrin 7355-1, në sipërfaqe prej 907 m². Gjykatat e kanë aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe për këtë janë dhënë prova të mjaftueshme të cilat në tërësi i pranon edhe kjo Gjykatë.

Është refuzuar si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë që e paditura si kompensim për sipërfaqen e munguar t'ia dorëzoj në shfrytëzim afatgjatë një sipërfaqe prej 5345 m², sepse e paditura nuk e kishte të drejtën për të disponuar lirisht në patundshmërinë në të cilën gjenden rrugët, trotualet, institucionet publike të cilat konsiderohen si të mirat të rëndësishme të veçantë, respektivisht për të garantuar interesin publik të qytetarëve e që janë në dobi të përgjithshme. Për këto arsye, gjykatat e instancës së ulët drejtë kanë konkluduar se kjo pjesë e kontratës nuk mund të ketë efekt të plotë juridik, konform nenit 46.2 lidhur me nenin 47 të LMD-së. Meqenëse kontrata është nule, nuk prodhon efekt juridik, objekti i detyrimit nuk ekziston, që paditësit t'i jepet në shfrytëzim ndonjë parcelë tjetër. Është i pabazuar pretendimi i të paditues lidhur me nulitetin e kontratës, pasi që gjykatat e instancës më të ulët, tani edhe Gjykata Supreme, kanë arsyetuar vlefshmërinë e një pjese të kontratës me efekt të plotë juridik, dhe në anën tjetër kanë arsyetuar një pjesë e cila nuk mund të prodhojë efekt juridik. Me të drejtë është aplikuar neni 510 LMD i cili parashikon se nëse shitësi nuk vepron sipas kërkesës së blerësit, në rast të tërheqjes së sendit nga blerësi, kontrata ndërpritet sipas ligjit, dhe në rast të reduktimit apo të kufizimit të së drejtës së blerësit, blerësi mund të ndërpres kontratën ose të kërkojë zbritje proporcionale të çmimit. Nëse shitësi nuk arrinë të përmbush kërkesën e blerësit për lirimin e sendit nga të drejtat dhe pretendimet nga një pale të tretë, brenda një kohe të arsyeshme, blerësi mund të ndërpres kontratën nëse kjo është arsyeja pse qëllimi i tij nuk mund të realizohet. Sidoqoftë, blerësi ka të drejtën e kompensimit për dëmin e shkaktuar. Lidhur me si më sipër, refuzimi i kërkesëpadisë së paditësit sa i përket kompensimit të patundshmërisë së munguar e cila ishte objekt i kontratës, nuk e përjashton nga mundësia për të kërkuar kompensim të dëmit eventual në

ndonjë procedurë tjetër nëse konsideron se kontrata nuk është respektu nga kontraktuesi tjetër. Në rastin konkret, është e pabazuar thirrja e paditësit në nenin 509 të LMD-së i cili parashikon se në rast kur pala e tretë ka të drejtën mbi pronën, sendin, blerësi është i obliguar ta njoftoj shitësin për lirim të sendit nga të drejtat dhe pretendimet të palës së tretë brenda një kohe të arsyeshme, në rast se objekti i kontratës janë sendet të përcaktuar gjenerike, dhe t'ia dorëzoj sendin tjetër pa ndonjë mungesë juridike. Kjo dispozitë nuk është e zbatueshme në rastin konkret, sepse nuk bëhet fjalë për pretendimet të palës së tretë, por për të mirat publike të rëndësisë të veçantë, dhe për këtë arsye nuk mund të kërkohet mbrojtja në dispoziten e lartpërmendur.

Gjykata Supreme shqyrtoj edhe pretendimet tjera, por ato ishin pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes.

Në bazë të asaj që u tha më lartë dhe me zbatimin e nenit 222 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Rev.nr.184/2018 më 20.02.2018

Kryetarja e kolegjit
Jellena Krivokapiq

Përktheu: Ferid Abazi